



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 27/2 Prot.

Tiranë, më 3/8/2010

**Lënda:** Rekomandim për **Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë.**

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë,**

**KONSTATOVA**

Më datë 30/05/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë,** me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë është kontrollues publik në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) Tiranë.

Ky kontrollues ushtron aktivitetin e tij mbështetur në ligjin nr. 8378 datë 22.07.1998 ‘Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë’, ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë fushën e transportit.

Në aktivitetin e tij ky kontrollues kryen shërbim ndaj subjekteve shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për regjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, për kontrollin teknik të mjeteve, për pajisjen e drejtuesve të mjeteve me lejë-drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve e të drejtuesve të mjeteve dhe për transmetimin e të dhënave të kërkuara nga policia e rendit si dhe shenjen e licencave të ndryshme.

Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë, mbledh dhe përpunon dokumente me të dhëna personale gjatë shërbimit që ofron për pajisjen e individëve (shtetas) me lejë drejtimi automjeti, për regjistrimin e automjeteve dhe ndryshimin e pronësisë së mjeteve.

Dokumentet që kontrolluesi mbledh për pajisjen e individëve (shtetasve) me lejë drejtimi janë; kërkesa e qytetarit, fotokopje e kartës së identitetit, vërtetimi i banimit, raporti mjekësor, autorizim model IV-7 i plotësuar nga auto shkolla, dokumenti i grupit të gjakut dhe rezusit, dëshmia e kryqit të kuq, fotografi. Në këto dokumente që mbledh kontrolluesi mbarten të dhëna personale të këtyre individëve si; emri, mbiemër, atësi, vendlindje, vendbanim, grupi i gjakut, rezusi.

Grupi i kontrollit këqyri disa praktika të pajisjes së individëve me lejë drejtimi, disa praktika të regjistrimit të automjeteve dhe ndryshimit të pronësisë së tyre dhe konstatoi që dokumentacioni që mbledhet dhe administrohet në këto praktika kalon në tre faza përpunimi. Në fazën e parë individët paraqiten pranë sporteleve të zyrave të pritjes së kontrolluesit dhe depozitojnë në formë shkresore dokumentacionet të përshkruara në formularin tip të publikuar nga ky kontrollues. Punonjësi i kontrolluesit bën verifikimin paraprak dhe krijon dosjen personale të individit duke e klasifikuar atë sipas shërbimit të ofruar. Ky dokumentacion i mbledhur dorëzohet brenda njëzet e katër orëve pranë zyrës së përpunimit ku tashmë në një fazë të dytë punonjës të tjerë të kontrolluesit (përpunues) bëjnë verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur, vendosin pranimin e atyre praktikave që plotësojnë kriteret, bëjnë hedhjen në regjistrin themeltar të të gjithë dokumentacionit për individët (shërbime lidhur me lejet e drejtimit), plotësohet kartela e mjetit dhe regjistri themeltar i mjeteve. Në fazën e tretë nga punonjës (operatorë) bëhet hedhja në sistemin kompjuterik të të gjithë të dhënave të mbledhura nga dokumentet shkresor, për regjistrimin e mjeteve dhe lejet e drejtimit për individë.

Praktikat për pajisjen e individëve me lejë drejtimi dhe ato të regjistrimit të mjeteve ruhen në arkiva të veçanta pranë kontrolluesit.

Sa më sipër, kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë nuk ka rregullore të brendshme, në të cilën të ketë specifikuar rregulla të veçanta, lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave personale, gjatë ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tij.

- *Nuk zbatohet neni 27/1 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale: “...Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi..”*

2. Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” mban në arshivë fizike pranë Departamentit të Personelit, dosje me dokumente që mbartin të dhëna personale të punonjësve, (subjekte të të dhënave personale) të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kontrollues prej me shumë se tre vjet. Mbajtja e dokumentacioneve me të dhëna personale të punonjësve për një periudhë deri në tre vjet pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga ana e kontrolluesit, justifikohet me faktin se këto dokumente mund të përdoren për arsye të konflikteve gjyqësore.

Të dhënat e punonjësve mblidhen për qëllim specifik të përcaktuar qartë për të lidhur një marrëdhënie punë mes kontrolluesit dhe punonjësit. Këto të dhëna duhet të mbahen të sakta, të përditësuara dhe të mbahen në atë formë që të lejojnë identifikim e subjekteve të të dhënave për një kohë por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika1/d i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”...“Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.
- Nuk respektohet neni 27/4 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”...“Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është e nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar”.

3. Pranë kontrolluesit “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë mblidhen, përpunohen, ruhen të dhëna personale të subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit të video vëzhgimit (CCTV).

Në ambientet e kontrolluesit “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë, u konstatuan dy sisteme video vëzhgim-regjistrimi CCTV.

- a) Sistemi i vjetër i menaxhuar nga titullari i Institucionit i cili monitorin ambientet e marrëdhënieve me qytetarin, korridoret, sallën e provimit të patentës dhe hyrjet në këtë Institucion. Ky sistem ka 16 kamera të instaluar.
- b) Sistemi i instaluar nga Drejtoria e Përgjithshme ( pjesë e projektit “Informatizimi i aktivitetit të DSHTRR-së“) e cila monitoron gjithashtu ambientet e marrëdhënieve me qytetarin, sallën e provimit të patentës, korridoret si dhe hyrjet në Institucion. Ky sistem ka 8 kamera të instaluar. Punonjësit e këtij kontrolluesi nuk kanë akses në të dhënat video të regjistruara në këtë sistem.

Për të dy sistemet nuk ekziston një dokument i qartë i cili përcakton qëllimin e përdorimit të sistemit të video vëzhgim-regjistrimit CCTV si dhe politikën e sigurisë për të dhënat video të cilat regjistrohen në këto sisteme.

U konstatua vendosje e tabelave informuese në lidhje me ambientet e mbikëqyrura me anë të sistemit CCTV (tabelat ishin me përmasa të vogla dhe subjekti nuk mund të informohej qartësisht).

Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë, në aktivitetin e tij përdor dy sisteme për regjistrimin e të dhënave të mjeteve dhe të lejeve të drejtimit të automjeteve. Një nga sistemet e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave bazohet në ORACLE dhe tjetri në “MY SQL”.

Gjatë inspektimit në ambientet e hedhjes së të dhënave të mjeteve, ambientin e vendosjes së serverave si dhe ambientet e monitoruara nëpërmjet sistemit të video vëzhgim-regjistrimit u konstatua se:

- Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë nuk vuri në dispozicion të grupit të kontrollit rregullore për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit për stafin e teknologjisë së informacionit dhe sigurinë e të dhënave personale që përpunohen me anë të këtij sistemi.
- Aksesit fizik në ambientet e serverave është i kufizuar nëpërmjet dyerve të kyçura dhe monitorimit me anë të sistemit të video vëzhgim-regjistrimit.
- Sistemi i rrjetit të brendshëm kompjuterik ndahet nga komunikimi me rrjetin e jashtëm nëpërmjet një “mur zjarri” (fireëall) (komunikimi me drejtorinë e përgjithshme).
- Nuk u konstatua rregullore në lidhje me konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale të cilat përpunohen nga ky kontrollues.
- U konstatuan kompjuterat të cilët nuk kishin kufizim aksesit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të punonjësit përkatës.
- Aksesit në të dhënat në server në disa raste bëhej pa fjalëkalim. Më saktë, aksesit fillestar teknikisht është mundësuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të punonjësit përkatës dhe ky fjalëkalim mund të memorizohet dhe në vazhdimësi nuk ka nevojë për konfirmim të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit. Në disa kompjutera u konstatua se, nuk ka akses të kufizuar për kompjuterin dhe për rrjedhojë, aksesit i të dhënave në server mund të arrihet edhe nga një punonjës i paautorizuar për të aksesuar të dhënat e një tjetër punonjësi të autorizuar në rast mungese të këtij të fundit.

- Backup i të dhënave në servera bëhet çdo muaj dhe i dërgohet drejtorisë së përgjithshme me anë të DVD-ROM ose CD-ROM.
  - Në këtë rast nuk zbatohen nenet 18-27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, udhëzimi nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”.
4. Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë nuk ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Nuk është zbatuar neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ...“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## R E K O M A N D O J

- 1) Në zbatim të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë, të hartojë rregullore të brendshme, në të cilën të ketë specifikuar rregulla të veçanta, lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave personale si dhe të përcaktojë rregulla të veçanta në lidhje me kohën e mbajtjes së të dhënave, sidomos përsa i përket dosjeve të personelit që ndërpresin marrdhëniet e punës me kontrolluesin. Të heqë nga arshiva fizike dosjet me dokumente që mbartin të dhëna personale të punonjësve, (subjekte të të dhënave personale) të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kontrollues prej me shumë se tre vjet.

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë mund të vendosë përdorimin e sistemit të video vëzhgimit (CCTV) në ambientet e punës vetëm në raste të veçanta, kur nevojitet për sigurinë e njerëzve

dhe pronës dhe kur ky qëllim nuk mund të arrihet me mënyra të tjera më të arsyeshme, duke pasur parasysh zbatimin e parimit të proporcionalitetit në raportin midis privatësisë së subjekteve të të dhënave personale dhe qëllimit të kontrolluesit. Në lidhje me këtë sistem duhet të hartojë rregulla për qëllimin e përdorimit të këtij sistemi, skemën, aksesin, konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet përdorimit të sistemit të CCTV-ve.

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të vendosen tabela informuese në të gjitha ambjentet të cilat mbikëqyren me kamera (sipas modelit standart të miratuar nga Komisioneri me Urdhërin Nr. 33, datë 27.06.2011).

- 2) Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë të plotësojë detyrimin për njoftim pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI  
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

